



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA ELBASAN  
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Elbasan, më \_\_\_\_ . \_\_\_\_ . 2021

**LËNDA:** Dërgim njoftimi i fituesit për botim në Buletinin e Njoftimeve Publike.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

T I R A N Ë

**NJOFTIMI I FITUESIT**

Nga: **Bashkia Elbasan** adresa: rruga “Qemal Stafa”, Elbasan.

Drejtuar: **“Ergi” sh.p.k.** me adresë: lagjja 28 Nëntori, Autostrada Elbasan - Metalurgji, km 3, Elbasan.

Procedura e prokurimit: **“Procedurë e Hapur”**.

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-09710-10-27-2021

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Rikonstruksioni i shesheve të pallateve 650, 651, 652, 653, në lagjen Partizani”**, me fond limit: **25,098,611** (njëzet e pesë milion e nëntëdhjetë e tetëmijë e gjashtëqind e njëmbëdhjetë) **lekë pa t.v.sh** vënë në dispozicion nga Buxheti i Bashkisë Elbasan, dhe me afat për kryerjen e punimeve **3 muaj nga data e lidhjes së kontratës**.

Publikime të mëparshme (*nëse zbatohet*): Buletini i Njoftimeve Publike [data] [nr]

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në kosto

oferta ekonomikisht më e favorshme bazuar në çmim

Me anë të këtij Njoftimi ju informojmë se, në këtë procedurë kanë marrë pjesë Ofertuesit e mëposhtëm me këto vlera përkatëse të ofruara:

**1. “Bajrami N” sh.p.k me Nipt: K 02727202 O**

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **18.538.020,8** (tetëmbëdhjetë milion e pesëqind e tridhjetë e tetëmijë e njëzet presje tetë) **lekë** (pa tvsh).

## **2. “Sark” sh.p.k me Nipt: K 52531415 H**

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **20,154,053** (njëzetmilion e njëqind e pesëdhjetë e katërmijë e pesëdhjetë e tre) **lekë** (pa tvsh).

## **3. “Ergi” sh.p.k me Nipt: K 02727229 P**

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **23,441,829** (njëzet e tremilion e katërqind e dyzet e njëmijë e tetëqind e njëzet e nëntë) **lekë** (pa tvsh).

## **4. BOE “ASI-2A CO” sh.p.k me Nipt: K 53002402 C & “ARDMIR” sh.p.k me Nipt: K 82509006 P & “VISCOS GROUP” sh.p.k me Nipt: L 96513208 E**

Vlera e paraqitur në procedurën e prokurimit është **19.056.814,40** (nëntëmbëdhjetëmilion e pesëdhjetë e gjashtëmijë e tetëqind e katërmëdhjetë presje dyzet) **lekë** (pa tvsh).

### **Nga pjesëmarrësit janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:**

#### **1. Operatori ekonomik “Bajrami N” sh.p.k me Nipt: K 02727202 O për arsyet e mëposhtëme:**

Në përmbushje të pikës 2.3.8: *"Ne përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates te publikuar ne SPE, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkëpunimi nga prodhuesi /distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë: Hekur..."*, OE ka paraqitur një kontratë paraprake furnizimi me datë 08.11.2021, ndërmjet tij si blerës dhe shoqërisë "Kelvis" sh.p.k. si furnitor. Referuar QKB-së së furnitorit, ai nuk është prodhues i hekurit, por nuk është as distributor i autorizuar nga prodhuesi, siç është kërkuar në pikën 2.3.8. të kriterëve të veçanta të DST-së. Subjekti "Kelvis" sh.p.k. nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion të tipit autorizim apo kontratë bashkëpunimi me prodhuesin e hekurit, shoqërisë "Kurum" sh.a., por ka dorëzuar vetëm disa certifikata ISO e teste laboratorike të këtij subjekti.

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

#### **2. Operatori ekonomik “Sark” sh.p.k me Nipt: K 52531415 H për arsyet e mëposhtëme:**

**1.** Në përmbushje të pikës 2.3.1. të kapacitetit teknik : *Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:*

a- punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b- punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

-Për të vërtetuar përvojen e mëparshme duhet të paraqiten:

-Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore: Formulari i vlerësimit i shoqëruar me: -Kontratë punimesh; -Situacion përfundimtar; -Akt-kolaudimi; -Procesverbal për marrje në dorëzim të punimeve të kryera.

-Nëse kontrata është realizuar me subjekte private: Formulari i vlerësimit i shoqëruar me: Kontratën, situacionin përfundimtar, aktin e kolaudimit, lejen e përdorimit, faturën tatimore të deklarimit të objektit në organet tatimore.

**Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojen e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.**

Asnjëra nga kontratat e paraqitura nuk plotëson kushtin e kërkuar në gjermën a) të kriterit 2.3.1 të kapacitetit teknik, pasi asnjëra nga kontratat nuk është sa 50 % e vlerës së fondit limit të prokuruar.

Gjithashtu, në përmbushje të këtij kriteri, OE ka dorëzuar dokumentacion të plotë për 9 (nëntë) objekte, shuma e të cilëve arrin vlerën **28,911,863 (njëzet e tetë milion e nëntëqind e njëmbëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë pa t.v.sh.**, duke mos përmbushur kushtin në gjermën b) të kriterit ku parashikohet: punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Vlera totale e të gjitha punëve të realizuara nga ky OE, në 5 vitet e fundit, është më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. OE nuk e përmbush këtë pikë të kapacitetit teknik.

**2.** Në përmbushje të pikës 2.3.8: "Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit përkatës të publikuar në SPE, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontratë bashkëpunimi nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë: Hekur...", OE nuk ka paraqitur asnjë autorizim apo kontratë furnizimi nga prodhuesi apo distributori për materialin hekur.

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se:  
3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të

vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji."

**3. BOE "ASI-2A CO" sh.p.k me Nipt: K 53002402 C & "ARDMIR" sh.p.k me Nipt: K 82509006 P & "VISCONS GROUP" sh.p.k me Nipt: L 96513208 E për arsyet e mëposhtëme:**

1. Në përmbushje të pikës 2.3.1. të kapacitetit teknik : Përvojë e suksesshme në ekzekutimin e të paktën:

a- punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50 % e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit e kontratës që prokurohet.

-Për të vërtetuar përvojen e mëparshme duhet të paraqiten:

-Nëse kontrata është realizuar me institucione shtetërore: Formulari i vlerësimit i shoqëruar me: -Kontratë punimesh; -Situacion përfundimtar; -Akt-kolaudimi; -Procesverbal për marrje në dorëzim të punimeve të kryera.

-Nëse kontrata është realizuar me subjekte private: Formulari i vlerësimit i shoqëruar me: Kontratën, situacionin përfundimtar, aktin e kolaudimit, lejen e përdorimit, faturën tatimore të deklarimit të objektit në organet tatimore.

***Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura për përvojen e suksesshme e bën ofertën të kualifikueshme.***

BOE "Asi 2A- Co" sh.p.k. & "Ardmir" sh.p.k. & "Viskons Group" sh.p.k. kanë dorëzuar dokumentacion për kontrata të lidhura, të cilat nuk konsiderohen si punime të ngjashme me objektin e prokurimit, pasi kontratat që operatorët ekonomikë kanë realizuar, janë kontrata për rikonstruksion objekti , k.u.z. apo mbrojtje lumore.

Konkretisht operatori ekonomik "Asi- 2A CO" sh.p.k. ka realizuar kontratën me objekt "Objekt thertore 1 kat + impjant fotovoltaik 150 kË + paisje".

Operatori ekonomik "Ardmir" sh.p.k. ka realizuar kontratën si nenkontraktor, me objekt "Mbrojtje nga lumi Vjosë në zonën Mifol krahu i majtë vazhdim" dhe "Mbrojtje nga lumi Seman, Suk Agacaj Fier".

Operatori ekonomik "Viskons Group" sh.p.k. ka realizuar kontratën si nenkontraktor, me objekt "Ndërtimi i kanalizimeve të ujrave të zeza në bllokun mbi rrugën nr.5, lagja nr. 3 Sarandë".

2. Referuar kontratës së bashkëpunimit ndërmjet operatorëve, oe "Ardmir" sh.p.k. ka marrë përsipër të realizojë 44 % të zërave të preventivit. Njëri nga zërat më me peshë është F.V. hekur betoni i zakonshëm Ø(6-10) mm, e duke iu referuar formularit përmbledhës të vetëdeklarimit të këtij operatori, ai ka deklaruar që do të bëjë furnizimin me hekur. Me qëlim përmbushjen e këtij kriteri, (pika 2.3.8. e kriterëve të veçanta të DST), OE ka paraqitur një kontratë noteriale furnizimi me nr. repertori 7539 dhe nr. koleksioni 3782, lidhur në Krujë ndërmjet tij si blerës dhe shoqërisë "Shijaku" sh.p.k. si furnitor. Referuar QKB-së së furnitorit, ai nuk është prodhues i hekurit, por nuk është as distributor i autorizuar nga prodhuesi (Subjekti "Shijaku" sh.p.k., nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të vërtetojë që është distributor i autorizuar nga një prodhues hekuri), siç është kërkuar në pikën 2.3.8. "Në përputhje me specifikimet teknike si dhe preventivit perkates te publikuar ne SPE, operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim/kontrate bashkepunimi nga prodhuesi /distributori, me të cilin prodhuesi/distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë këto pajisje/mallra në këtë procedurë prokurimi, si më poshtë: Hekur".

Në LPP nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", neni 92, pika 3, parashikohet se: 3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë subjektin: "**Ergi**" sh.p.k me adresë: lagjja 28 Nëntori, Autostrada Elbasan - Metalurgji, km 3, Elbasan, se oferta e paraqitur, me një vlerë totale prej **23,441,829** (njëzet e tremilion e katërqind e dyzet e njëmijë e tetëqind e njëzet e nëntë) **lekë** (pa tvsh), është identifikuar si oferta e suksesshme.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 109 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020, "Për Prokurimin Publik".

**TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR  
PERSONI I AUTORIZUAR PREJ TIJ**

**Zv.Kryetari  
Irland Sina**